



UNIVERSITETI
BARLETI

RREGULLORE

***MBI MASAT HIGJENO SANITARE, ORGANIZATIVE DHE
ADMINISTRATIVE***

***PER MINIMIZIMIN E RISKUT
NDAJ COVID - 19***

Tiranë, Tetor 2021



Përmbajtja

Hyrje.....	
Hyrja dhe dalja nga ambjentet e UniBa.....	
Distancimi fizik dhe qëndrimi dhe mësimi në klasa/auditore.....	
Zhvillimi i veprimtarive akademike.....	
Mbajtja e maskave dhe dorezave.....	
Lëvizjet brenda ambjenteve të Universitetit.....	
Dezinfektimi dhe higjena.....	
Asistenca psiko-sociale dhe shëndetësore.....	
Për personelin e UniBa.....	
Shtjocë	

Hyrje

Universiteti Barleti, (në vijim UniBa) në kushtet e pandemisë nga COVID 19, në përputhje me Urdhër nr. 413, datë 24.09.2021, Urdhër Nr. 413/1, datë 27.09.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Udhër Nr. 5, datë 28.09.2021 të Rektoratit të UniBa, Urdhër nr. 395, datë 06.10.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në vijim të urdhrave dhe udhëzimeve të mëparshme, ka hartuar këtë Rregullore të brendshme, lidhur me masat e domosdoshme, për të garantuar kushtet e sigurisë shëndetësore, për studentët ashtu edhe personelin akademik/administrativ të institucionit, për fillimin e vitit Akademik 2021-2022.

Kjo Rregullore dhe plani i masave higjieno-sanitare, organizative dhe administrative për minimizimin e riskut kundrejt COVID-19, është hartuar nga Grupi i Punës i specialistëve të autorizuar në përputhje edhe me protokollin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Objektivi i masave të përfshira në këtë Rregullore është të minimizojnë riskun për infektimin nga COVID -19, përmes distancimit fizik dhe dezinfektimit.

Aktiviteti akademik me praninë fizike të studentëve, për seancat konsultuese dhe provimet, do të zhvillohen duke zbatuar masat e mëposhtme.

Hyrja dhe dalja në mjediset e Universitetit Barleti

Studentët do të jenë të pranishëm në UniBa sipas orarit dhe grafikut të përcaktuar nga Sekretaria Mësimore, nën monitorimin e pedagogëve dhe stafit administrativ dhe mbështetës, i cili duhet të zbatohet rigorozisht.

Në hyrje të mjedisit të institucionit dhe ndërtesës së mësimit dhe në dalje të saj, qëndron një anëtar i personelit administrativ i ngarkuar për të monitoruar largësinë 1.5 - 2 metra. Në mjediset ku do të zhvillohen leksionet, seminarët, praktikat apo provimet, realizimi i këtij kushti do të monitorohet edhe nga pedagogu i lëndës.

Studentët me shenja të sëmundjes, të këshillohen të largohen, të qëndrojnë në shtëpi dhe të informojnë Sekretarinë Mësimore përmes telefonit/email. Sekretaria Mësimore informon në Departament për çdo rast të evidentuar.

Akomodimi i studentëve në salla, asistohet nga një anëtar i personelit administrativ dhe më tej është përgjegjësi e pedagogut të lëndës sistemimi në sallat përkatëse dhe monitorimi i zbatimit të masave.

Distancimi fizik dhe qëndrimi në klasa/auditore

Në mjediset e jashtme dhe në klasa/auditor do të ruhet distanca prej 1.5 - 2 metra mes studentëve, duke vendosur shenja dhe sinjalistika orientuese dhe duke afishuar informacion të dukshëm, si në mjediset e jashtme dhe të brendshme.

Nëse numri i studentëve është më i madh se sa hapësira e klasës/auditorit në mënyrë që të lejojë zbatimin kushteve të distancimit sipas kësaj Rregulloreje, për të respektuar këtë kusht, aktiviteti

akademik si mësimi, konsultimi, provimi etj, do të zhvillohet në më shumë se një grup (grupi do të ndahet në disa nëngrupe).

Përshtatja e orareve do të bëhet në marrëveshje mes departamenteve dhe Sekretarisë Mësimore, nën organizimin dhe drejtimin e dekanëve të fakulteteve.

Anëtarët e grupit të punës për masat higjieno - sanitare, pjesë e stafit mbështetës administrativ, organizojnë vendosjen e tavolinave dhe shenjave orientuese duke respektuar rregullin e distancës fizike mes studentëve.

Në klasë/auditor të gjithë studentët dhe pedagogu do të jenë të pajisur me maska dhe t'i mbajnë ato, detyrimisht, gjatë gjithë orarit që do të qëndrojnë në auditore.

Në çdo mjedis të mbyllur ku zhvillohet konsultime dhe provime, afishohen në vende të dukshme masat e parashikuara në këtë Rregullore, duke u bërë të njohura për të gjithë studentët dhe punonjësit.

Zhvillimi i veprimtarive akademike

Mësimi do të zhvillohet, nga e Hëna në të Shtunë, në fasha të caktuara orare, për të bërë të mundur distancimin e mjaftueshëm, për vitet e ndryshme të programeve të studimit; si rrjedhojë kapacitetet infrastrukturore të UniBa, duhet të rezultojnë të mjaftueshme për të zhvilluar procesin akademik në situatën e emergjencës COVID-19.

Mbajtja e maskave

Në auditor dhe në të gjitha mjediset e mbyllura, studentët dhe stafi akademik dhe administrativ mbajnë maska përgjatë gjithë kohës që studenti apo punonjësi ndodhet në institucion i angazhuar në proceset akademike dhe administrative.

Në hyrjen e çdo mjedisi afishohet një kujtesë lidhur me mbajtjen e maskave.

Lëvizjet brenda mjediseve të institucionit

Në mjediset e brendshme të UniBa do të lejohen të lëvizin vetëm studentët dhe personeli të cilët kanë dorëzuar certifikatën e vaksinimit të Covid-19 nga e-albania apo kartën e vaksinimit. Të gjithë ata të cilët nuk janë vaksinuar, duhet të dorëzojnë cdo ditë të hënë dokumentin e testit PCR. Studentët të informohen që të minimizojnë lëvizjet e panevojshme nëpër korridore.

Në dysheme dhe mure do të vendosën sinjalistika lidhur me distancimin social dhe orientimin në auditorët përkatëse.

Dezinfektimi dhe higjiena

Studentët, personeli akademik, administrativ dhe ai mbështetës ndihmës (sanitare dhe roje) përdorin maskat gjatë gjithë kohës së qëndrimit në UniBa, dezinfektojnë duart gjatë hyrjes/daljes në/nga klasë/auditor duke përdorur pajisjet me dezinfektantë të vendosur për këtë qëllim në mjediset e UniBa.

Sipërfaqet e tavolinave në auditore do të dezinfektohen nga personeli administrativ mbështetës, pas çdo aktiviteti mësimor duke përdorur pajisjet e vendosura në auditorë për këtë qëllim.

Në mjediset e UniBa afishohen kujtues për dezinfektimin e duarve, sipërfaqeve të tavolinave si dhe ruajtjen e distancës.

Do të sigurohet ajrosja e vazhdueshme e klasave/auditorëve.

Klasat dhe mjediset dezinfektohen në mënyrë të vazhdueshme nga personeli sanitar.

Personat e ngarkuar me monitorimin e procesit të kontrollit të studentëve në hyrje, dezinfektimin, vendosjen e dezinfektuesve dhe masave të tjera të nevojshme janë **Drejtuesi i Shërbimeve Mbështetëse dhe Infrastrukturore dhe Përgjegjësi për Sigurinë e Objekteve.**

Asistenca Psiko-Sociale dhe Mjekësore

Në çdo rast, nëse studenti do të shfaqë shenja të stresit dhe ankthit, do të asistohet nga shërbimi psiko-social dhe mjekësor i institucionit, shërbim i cili duhet të sigurohet nga sektori i administrimit.

Për çdo student që shfaq probleme shëndetësore, si rritje temperature etj, do të njoftohet menjëherë Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor.

Për personelin e UniBa

Në kuadër të zbatimit të kësaj Rregullore, me qëllim minimizimin e rreziqeve ndaj Covid-19, grupi i punës, do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të planit të veprimit të parashikuar në këtë rregullore, menaxhimin e situatës dhe garantimin e zbatimit me përpikmëri të standardeve dhe protokollit të miratuar.

Prof. Dr. Suzana GUXHOLLI

REKTOR